



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/130
Podujevë,
12.03.2026

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 64.4, nenit 19 pika 1.19, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dt. 29.06.2018, nenit 15 dhe 16 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Drejtoria e Arsimit, publikon:

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN AKADEMIK 2025 - 2026

Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë :

- Vetëm studentët e rregullt – viti i dytë (II) e tutje të regjistruar në **fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës**, duke përjashtuar studentët në studimet pasuniversitare – master dhe doktoratë;
- Studentët duhet të mos jenë përsëritës të vitit akademik;
- Të jenë banor të Komunës së Podujevës.

Nr.	Kriteret e veçanta	Përshkrimi	Pikët
1	Nota mesatare	Nota mesatare prej 9 – 10	30 pikë
1.1		Nota mesatare prej 8 – 9	20 pikë
1.2		Nota mesatare prej 7 – 8	15 pikë
1.3		Nota mesatare prej 6 – 7	10 pikë
2	Numri i studentëve në familje	Dy (2) ose më shumë studentë në familje	10 pikë
3	Kategoritë e dala nga lufta	Student që i përket kategorive të dala nga lufta	10 pikë
4	Student me asistencë sociale	Student që është përfitues i asistencës sociale	10 pikë
5	Fusha deficitare të studimit	Student në programe ku ka mungesë të kuadrove	10 pikë
5.1		(Mjekësi e Përgjithshme, Inxhinieri Elektrike, Mekanikë dhe Kompjuterikë, Ndërtimtari dhe Arkitekturë, Matematikë, Fizikë)	
6	Student me nevoja të veçanta	Student me nevoja të veçanta	10 pikë
7	Student pa të dy prindërit	Student pa të dy prindërit	20 pikë
8	Student pa njërin prind	Student pa njërin prind	10 pikë

Vëmendje: Kriteret e veçanta sipas pikës 2 (2 e më shumë studentë në familje), vlerësohen **vetëm për një student të asaj familje** dhe vetëm nëse dëshmon me dokumentacion zyrtar se të gjithë studentët e asaj familje i plotësojnë kriteret e përgjithëshme.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Aplikacioni sipas formës së Komunës së Podujevës;
- Kopja e ID-së së studentit;
- Vërtetimin se studenti ka regjistruar vitin akademik **2025 -2026 (origjinale)**;
- Kopja e dokumentit të identifikimit;
- Certifikata e notave (origjinale);
- Certifikata e vendbanimit;
- Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
- Vërtetim për shfrytëzimin e ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Podujevë (kjo vlenë për shfrytëzuesit që aktualisht marrin ndihmë sociale);
- Vendimi/vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorit;
- Për studentët pa njërin ose dy prindërit-Certifikata e vdekjes;
- Për studentët me nevoja të veçanta- vendimi/vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Vini re

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e Komunës – rr. “Nuhi Gashi”, në afat prej **15** ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës, në mediat e shkruara dhe në web-faqen e Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> , gjegjësisht nga data: **12.03.2026** deri më **27.03.2026**.

Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe nga numri i atyre që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës.

Drejtori
Ayni Fetahu

